

VENDIM
Nr. 267, datë 6.4.2016

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMIVE
PYJORE “ZALL-DEVOLL” DHE “MOLLAS” TË QARKUT ELBASAN, QË DO TË
PËRDORET NGA SHOQËRIA “DELIA GROUP” SHPK, PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE “THANË” DHE “MOLLAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 90 ha, në ngastrat 1b, 3, 4a, 4b, 5a, 5b, 6, 7c 8b, 9c, 10c, të ekonomisë pyjore “Zall-Devoll”, dhe në ngastrat 2, 3, 4, të ekonomisë pyjore “Mollas”, të qarkut Elbasan, që do të përdoret nga shoqëria “Delia Group” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Thanë” dhe “Mollas”, të hiqet nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Subjekti “Delia Group” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë një sipërfaqe të barabartë me atë të marrë në përdorim. Vlera e sipërfaqes së hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga subjekti “Delia Group” sh.p.k., në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Delia Group” sh.p.k., të pyllëzojë me fondet e veta, brenda 5 (pesë) viteve, sipërfaqen 90 ha, fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara nga Ministria e Mjedisit në marrëveshjen e lidhur me subjektin “Delia Group” sh.p.k.

4. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes nga shoqëria “Delia Group” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet “fond pyjor”, sipas mënyrës së rehabilitimit.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela 1 - Sipërfaqet që do të hiqen nga fondi pyjor sipas përdorimit të territorit dhe pronësisë

Nr	Emërtimi i ekonomisë	Ngastra	Sip. që do hiqet (ha)	Përdorimi territorit	Qeverisja	Funksioni kryesor	Pronësia
1	Zall-Devoll	1b	4.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
2	Zall-Devoll	3	6.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
3	Zall-Devoll	4a	8.2	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
4	Zall-Devoll	4b	2.8	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
5	Zall-Devoll	5a	6.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
6	Zall-Devoll	5b	9.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
7	Zall-Devoll	6	8.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
8	Zall-Devoll	7c	5.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
9	Zall-Devoll	8b	7.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
10	Zall-Devoll	9c	2.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
11	Zall-Devoll	10c	1.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
12	Mollas	2	8.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
13	Mollas	3	7.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
14	Mollas	4	10.5	inproduktive	inproduktive	shtrat lumi	shteterore
TOTALI			90				

